

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE

GREEN EUROPEAN INVESTMENT SH.P.K.

Sot me date 14.09.2022,

VJOELA ALLKANJARI, atësia Llazar, shtetase italiane, lindur me 14/03/1986, ne Tirane (TR) SHQIPERI dhe banues ne Tirane, rruga Njazi Meka nr. 3 Tirane, madhore me zotësi te plote juridike për te vepruar, e identifikuar me karte identiteti me Nr.I65314071W. bazuar, ne legjislacionin ne fuqi veçanërisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14. 04.2008 «Për Shoqëritë Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Për Qendre Kombëtare te Regjistrimit ", LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDREN KOMBETARE TE BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilësinë e ortakeve themelues si dhe ne vullnetin tim te lire te shprehur dhe ne nënshkrimin e akteve te themelimit te shoqërisë kam hartuar aktin e themelimit dhe statutin e një Shoqërie me Përgjegjësi te Kufizuar (me poshtë shoqëria):

KREU 1

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI I THEMELUESIT

Sot ne date 14.09.2022, u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin

"GREEN EUROPEAN INVESTMENT" SHPK

Themeluesit e shoqerise jane:

- 1. TOZZI FERNANDO, shtetas italian, lindur me 25.05.1941, ne TERNI (TR) Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me kartën e identitetit italiane me Nr. AS0396984.*
- 2. PETRUCCI FERNANDO, shtetas italian, lindur me 01.07.1955, ne BARI (BA) Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr. YB722056.*
- 3. ROSSI GIUSEPPE, shtetas italian, lindur me 25.09.1959, ne VOGHERA (PV) Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr. YB4995295.*

4. *URSO NICOLA, shtetas italian, lindur me 08.01.1965, ne GAGLIANO DEL CAPO (LE) Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr. YB0343164 .*
5. *SCAGGIANTE DINO, shtetas italian, lindur me 14.05.1968, ne Venezia (VE) Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr. YB5536883.*
6. *PETRONILLI DIEGO, shtetas italian, lindur me 21.02.1977, ne ROMA (RM) Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YB7588862.*
7. *COSOLA NICOLA DOMENICO; shtetas italian, lindur me 08.01.1965, ne VENEZIA (VZ) Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr. n. YB5536883 .*
8. *ECLIPSE CONSULTING SHPK; shoqëria e përfaqësuar nga Z. Marco Signorini, , shtetas italian, lindur me 11/05/1960, ne Ancona(AN) Itali, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me pasaporten italiane me Nr.YA7646123, me seli ne Bulevardi Deshmoret e Kombit, Qendra e Biznesit "Kullat Binjake" kati 2, Tirane, e identifikuar ne QKB me NIPT nr: M21816005A;*

**NENI2
OBJEKTI I SHOQERISE**

- Menaxhim financiamenti dhe realizim projekti

**NENI3
KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pakufizuar.

**NENI.4
SELIA E SHOQERTSE**

Selia e Shoqerise eshte ne adresen:. Rr. Njazi Meka Nr. 2, Tirane.

**KREU II
KAPITALI
NENI5
KAPITALI I REGJISTRUAR**

Kapitali i regjistruar i shoqërisë do te jete 100.000 (një qind mije) leke i perbere nga 8 kuota. *Pjesemarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise jane: Kontributi ne kapitalin e shoqerise zoterohet nga Ortaket ne masen:*

Emer	Nr. Kuotave	Perqindje	Vlera ne ALL
1. TOZZI FERNANDO	1	8 %	8000
2. PETRUCCI FERNANDO	1	8 %	8000
3. ROSSI GIUSEPPE	1	8 %	8000
4. URSO NICOLA	1	8 %	8000
5. SCAGGIANTE DINO	1	8 %	8000
6. PETRONILLI DIEGO	1	8 %	8000
7. COSOLA NICOLA Domenico	1	5 %	5000
8. ECLIPSE CONSULTING SHPK	1	47 %	47000

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

NENI6 ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqërisë.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI 7
TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre

mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegirnise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve. Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III
ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE
NENI 8
ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per manjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e. Percaktimi i shperblimeve per persona te permendur ne shkronjat c) e d)
- f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire perгатitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g. Miratimi,i bilanceve
- h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
 - 1. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- J. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k. Riorganizirni dhe prishja e shoqerise
 - 1. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m. Ceshlje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9
THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim n p rmjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dit s e t'u d rgohet te gjith  ortakeve, jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vet m nese te gjith  ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

NENI 10
KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualiflkuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiperm nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vonë se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11
MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me 3/4 e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shpemdardjen e fitimeve, riorganizmin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtje te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12
PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin per:

- a) vleresmin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimii ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autonzuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13
ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte ripertesitje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB. Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te pakufizuara administrimi:

- VJOELA ALLKANJARI, atesia Llazar, shtetase italiane, lindur me 14/03/1986, ne Tirane (TR) SHQIPERI dhe banues ne Tirane, rruga Njazi Meka nr. 2 Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, e identifikuar me karte identiteti me Nr.I65314071W.

NENI 14
KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dlze detyrolzen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajljen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe
- e) Raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shpemdarnjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15
PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Administratoret te cilet kane kryer veprime ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.

2. Nese administratori vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREUIV
VITI FINANCIAR -EKSPERTET
NENI 16
VITI FINANCIAR

Viti finaciar i Shoqerise filion me date 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, përrjashtimisht, viti i pare finaciar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor.

NENI 17
EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finaciar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara.

KREU 5
PRISHJA DHE RIORGANIZIMI I SHOQERISE
NENI 18
PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b. Me vendimet e asamblese se Ortakeve

- c. Me hapjen e procedurave te falimentit
- d. Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"
- e. Me vendim gjykate.

NENI 19 RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare.

NENI 20 KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortaket dhe administratoret e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jene te punesuar ne nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne te njejten fushe me te paren. Ndalimi i pikes 1 mund te anulohet ne asamblene e pare te pergjithshme me 3/4 e votave sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjit per shoqerite tregtare.


NENI 21 LEGJISLACIONI

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 22 MOSMARRVESHJET

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Tiranës. Ky akt, u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italjane, me vlere te njejte ligjore.

ORTAKET THEMELUES




TOZZI FERNANDO



PETRONILLI DIEGO



PETRUCCI FERNANDO



COSOLA NICOLA DOMENICO



ROSSI GIUSEPPE



URSO NICOLA



Scaggiante Dino



ECLIPSE CONSULTING SHPK
(me përfaqësues ligjor Z. Marco Signorini)

